



KOMUNA E HANIT TË ELEZIT



	REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA • OPSTINA • MUNICIPALITY		
HAN I ELEZIT		
Nr.i Prot.	06 / 950	
Nr.i Faq.	9	Data 08.02.2021

R A P O R T

MBI PUNËN E DREJTORISË SË URBANIZMIT, KADASTRIT
DHE MBROJTJA E MJEDISIT PËR VITIN 2020

HANI I ELEZIT, Janar 2021

URBANIZMI

Situata e krijuar me veprimin e pandemisë Covid-19 si dhe masat kufizuese të Qeverisë së Republikës së Kosovës me qëllim të parandalimit të përhapjes së sajë, kanë bërë që DUKMM, detyrueshëm të reduktoj aktivitete të caktuara sidomos në fushën e planifikimit, organizimit të diskutimeve publike, aktiviteteve mjedisore etj. dhe si rezultat i këtyre masave poashtu është shënuar interesim më i ulët i qytetarëve për marrje të shërbimeve kadastrale. Mirëpo pavarishtë situatës së rënduar nga Covid 19, Komuna ka arritë të përmbyllë me sukses të gjitha projektet kapitale të parapara për realizim vitin 2020. Po ashtu, Drejtoria ka arritë të mbajë nivelin e të hyrave në raport me vitin paraprak madje ka shënuar një ngritje të lehtë të të hyrave- afërsishtë për 2.2% më shumë se vitin 2020.

I PLANIFIKIMI

Në periudhën raportuese Janar-Qershor 2020, pavarishtë veprimit të pandemisë Covid 19, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit ka zhvilluar aktivitete të caktuara në fushën e planifikimit hapësinor respektivishtë hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës. Sa i përket hartimit të PZHK-s, Komuna ka organizuar takimin kryesor respektivishtë puntorinë 3 ditore nga dt.06-08 Mars'2020 lidhur me përcaktimin e prioriteteve strategjike zhvillimore të Komunës (vizionimi) në të cilën kanë marrë pjesë tridhjetë pjesëmarrës: komplet grupi i planifikimit Komunal, përfaqësues të Kuvendit, të OJQ-ve, të bizneseve etj. Me organizimin e kësaj punëtorie e cila është vlerësuar si shumë e mirë, pothuajse ka përfunduar pjesa më e madhe e punës në hartimin e PZHK-s.

Po ashtu, DUKMM ka filluar dhe përgaditjet e nevojshme për fillimin e hartimit të Hartës Zonale Komunale (HZK-s). Në fakt, me 5 Maj 2020, Komuna ka nënshkruar memorandum të mirëkuptimit me Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH, përmes së cilës GIZ-i Gjerman do ta mbështes Komunën në hartimin e HZK-s si dhe avancimin e sistemit Komunal të planifikimit hapësinor në Han të Elezit. Në këtë drejtim GIZ-i Gjerman përmes procedurave të tenderimit ka përzgjedhur kompaninë "PLAN A CONSULTING" Prishtinë për hartimin e Hartës Zonale të Komunës. Vlera e projektit është 50,000 € prej të cilave 35,000 i financon GIZ-i kurse Komuna 15,000€. Ndërkaq shpenzimet tjera siq janë ato të organizimit të diskutimeve publike, mbledhjes së të dhënave në teren, organizimin e puntorive etj. do ti mbulon GIZ-i. Kompania e përzgjedhur për hartimin e HZK-s menjëherë pas nënshkrimit të kontratës me Giz-n Gjerman ka filluar me hartimin e HZK-s.

II PROJEKTET INVESTIVE KAPITALE

Sektori i Urbanizmit në vazhdimësi ka qenë i angazhuar në të gjitha projektet investive kapitale përmes:

- Përgaditjes së paramasave dhe parallogarive për projektet kapitale të parapara për realizim vitin 2020,
- Mbikqyrjes së vazhdueshme të punimeve në teren dhe ndihma punëkryesve në realizimin e projekteve,
- Përgaditjen e aplikacion projekteve për donator të ndryshëm,
- Përgaditjen e raporteve për projektet kapitale për Komunë, raporteve progresive të projekteve për zyrën e prokurimit etj.

Më poshtë po japim listën e projekteve kapitale për realizim vitin 2020 të miratuar nga Kuvendi Komunal:

Nr.	PROJEKTET KAPITALE	Financuesi i projektit	Buxheti (kostoja e projektit)	Punëkryesi	Statusi momental	Kohëzgjatja e projektit
1	Shtrimi me kubëza betoni i rrugicave nëpër zonat urbane dhe rurale të Hanit të Elezit (lot 1, lot 2)	Komuna	182,995 (lot 1) 27,977	Kema Comperi	E përfunduar	2019, 2020
2	Kanalizimi fekal në zonat rurale	Komuna	18,791	Arlindi sh.p.k	Përfunduar	2020
3	Rihapja dhe zgjerimi i rrugës Hunel-Hasallar-Lagjia e Re	Komuna	21,050	Murseli Comperi	Përfunduar	2020
4	Ndërtimi i Qendrës Kulturore (faza dytë)	Komuna MKRS	409,985 477,448	ATC COM. DAJTING	Në realizim e sipër	2019, 2020 2021
5	Ndërtimi i sallës sportive SHFMU. "Kështjella e Diturisë" Paldenicë	Komuna MZHR	257,833	NNP ENGINEERING	E përfunduar	2019, 2020
6	Ndërtimi i sallës së sportive në SHFMU	Komuna MAPL	316,346	ATC COM	Në realizim e sipër	2020 2021

	Veli Ballazhi Gorancë	MZHR				
7	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në zonat rurale dhe urbane	Komuna	21,687 31,929	RAHOVICA ATC COM	Përfunduar	2020
8	Fond për hartimin e projekteve (HZK)	Komuna	15,000	Plan A Consulting	Në realizim E sipër	2020 2021
9	Rregullimi i shkollës së vjetër (shkolla muze) Krivenik	Komuna	14,935	ATC COM	E përfunduar	2020
10	Rregullimi i pllakës përkujtimore në f. Dromjak, pllakës përkujtimore në f. Krivenik dhe rregullimi i ndriqimit- pllaka përkujtimore Gafur Loku	Komuna	4,377	MERGRANT ING	E përfunduar	2020
11	Ndërtimi i trotuarit dhe shtegut për persona me aftësi të veqanta	Komuna	21,284	Murseli Compani	E përfunduar	2020

Shënim: Në listën e projekteve kapitale janë paraqitur vetëm projektet me kod 66480 Planifikimi Urban dhe Inspeksioni dhe jo projektet e tjera të cilat janë në listat e Drejtorive tjera.

III LEJET E DHËNA NDËRTIMORE DHE LEJET E PËRDORIMIT

Gjatë kësaj periudhe, janë regjistruar 19 aplikime për leje ndërtimore dhe janë dhënë 19 leje ndërtimore, një më pak se vitin paraprak (pa llogaritur dy leje të legalizimit).

regjistri i lejeve ndërtimore të lëshuara nga DUKMM vitin 2020

1. Islam Koka, objekt komercial (garazh), sip 440 m², taksa kom. 440€,
2. Nexhat Kaloshi, shtëpi individuale sip. 612 m², taksa kom. 612€,
3. Reshat Bushi, shtëpi individuale sip. 183 m², taksa kom. 183€,
4. Muamet Berisha, shtëpi banimi sip. 199 m², taksa kom. 199€,
5. Basri Kalisi, shtëpi banimi-afarizëm sip. 400m², taksa kom. 400€,
6. "Elkos" sh.p.k.-ETC, qendër tregtare, sip. 1934 m², taksa kom. 1,934€,

7. DAKRS-Komuna Hani Elezit, halla e sportit, Gorancë, sip. 762m², taksa komunale 0.00€,
8. Nazmi Dernjani, shtëpi individuale sip. 242m², taksa komunale 242€,
9. Zeqirja Kuka, objekt banimi-afarizëm, sip.956m², taksa kom. 956€,
10. Xhafer Loku, shtëpi individuale 218 m², taksa kom. 218€,
11. Sutki Kaloshi, shtëpi individuale sip. 260m², taksa komunale 260 €,
12. Sutki Kaloshi, shtëpi individuale sip.252m², taksa kom. 252€,
13. Samet Berisha, shtëpi individuale, sip. 134m², taksa kom. 134€,
14. Afit Dernjani, shtëpi individuale sip.152m², taksa kom. 152€,
15. Naim Kalisi, shtëpi individuale sip. 170m², taksa kom. 170€,
16. Muhamed Dernjani, shtëpi banimi sip. 180m², taksa kom. 180€,
17. Asan Shkreta, objekt banesor-afaristë sip.2023m², taksa kom. 2,023€,
18. Fuad Hasallari, shtëpi individuale sip.158m², taksa kom.158€,
19. Sulejman Dushlaki, shtëpi individuale sip. 442m², taksa kom. 442€,

Nga regjistri i lejeve të dhëna ndërtimore shihet se Urbanizmi, në emër të taksave ka realizuar të hyra në shumë prej 8,959.71€ apo 37.3% më shumë se vitin 2019.

Emërtimi	VITI 2019	VITI 2020	Rritja në %
Nr. i lejeve ndërtimore	20	19	
Të hyrat (taksa nga lej. ndërtimore)	6,522 €	8,959 €	37.3%

regjistri i lejeve të dhëna të përdorimit vitin 2020

1. "ELKOS" sh.p.k.-ETC, qendra tregtare.

IV TRAJTIMI INDËRTIMEVE PA LEJE NDËRTIMORE (LEGALIZIMI)

Nga fillimi i muajit Qershor, Komuna e Hanit të Elezit respektivisht Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit ka filluar me trajtimin e ndërtimeve pa leje ndërtimore sipas Ligjit të ri nr.06/L-024 për trajtimin (legalizimin) e ndërtimeve pa leje të kategorisë parë dhe kategorisë dytë i cili ka hyrë në fuqi me 5 Shtator 2018.Me këtë Ligj, janë reduktuar kërkesat për numrin e dokumenteve të cilat kërkohen për legalizim si dhe është mundësuar ulja e kostos (shpenzimeve) për aplikim. Ligji, gjithashtu parasheh hartimin dhe aprovimin e programeve të veqanta për trajtimin e ndërtimeve pa leje në prona publike, prona shoqërore, toka bujqësore

nën komasacion dhe nën sistem të ujitjes, koridore infrastrukturore, sipërfaqe të mbrojtura, zona të veqanta të mbrojtura etj.

Përndryshe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit ka planifikuar nisjen e procesit të legalizimit në teritorin e Komunës nga fillimi i vitit 2020, mirëpo për shkak të pandemisë Covid 19 kemi qenë të detyruar që këtë proces ta prolongojmë gjerrë në muajin Qershor. Nga fillimi i muajit Qershor kemi filluar me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje ndërtimore me çrast janë shënuar rastet e para të aplikimit të qytetarëve për legalizim të objekteve dhe ate kryesishtë shtëpive individuale. Edhe pse numri i të interesuarve për legalizim është i vogël (dy qytetar vetëm janë pajisur me qertifikatë legalizimi për shtëpi individuale 6-7 të tjerë aplikues janë futur në listë të pritjes për shkak të problemeve pronësore.

Të hyrat e realizuara nga Legalizimi

Numri i legalizimeve	Të hyrat 2020
2	567€

V SHFRYTËZIMI I TOKËS NDËRTIMORE PRONË E KUVENDIT të KOMUNËS

Në fillim të vitit kalendarik, me propozim të DUKMM, Kryetari i Komunës ka themeluar një komision për verifikimin e pronave Komunale të dhëna me qera (toka dhe objektet pronë e Komunës). Bazuar në këtë raport të komisionit në Han të Elezit janë 23 shfrytëzues me kontratë të tokës pronë e Kuvendit Komunal (ku janë të vendosura kryesishtë lokalet me karakter të përkohshëm, garazhe etj.) si dhe gjashtë shfrytëzues të objektit banesor (banesa e të vetmuarve-pesë prej tyre për qëllime të banimit dhe njëri për lokal). Sipërfaqja e përgjithshme e tokës të dhënë me qera është afërsishtë 650.m² ndërkaq sip. e banesave të dhëna me qera është 392.5m². Faturimi vjetor për shfrytëzuesit e pronës Komunale (tokës dhe banesave) është 6,042€. Me propozim të Kryetarit dhe vendim të Kuvendit të Komunës shfrytëzuesit e pronës Komunale janë liruar nga pagesa e qerasë për gjatë muaj si rezultat i ndërmarrjes së masave lehtësuese për shfrytëzuesit e pronës Komunale në kohë pandemie. Përndryshe në periudhën raportuese, Drejtoria ka inkasuar në emër të taksës për shfrytëzim të pronës Komunale shumë prej 6197 € apo 2,212€ më pak se vitin paraprak. Kjo ulje e të hyrave nga qeraja më së shumti i referohet masave lehtësuese sipas vendimit të Kuvendit Komunal. Përndryshe për herë të parë prej themelimit të Komunës, të gjithë shfrytëzuesit e tokës (lokalet afariste) si dhe shfrytëzuesit e banesave kanë paguar në tërsi faturat e qerasë (100%) për vitin 2020.

Të hyrat e Komunës nga shfrytëzuesit e tokës pronë Komunale 2020

Emërtimi	VITI 2019	VITI 2020	Ulja në në %
Të hyrat nga qirraja	8,409 €	6,197 €	35.6%

VI MBROJTJA E MJEDISIT

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë bërë inspektime të rregullta nga inspektorja e mjedisit dhe aty ku është parë e arsyeshme janë bërë vërejtje me gojë si dhe në 5 (pesë) raste janë shqiptuar gjoba mandatore në shumë prej 240€. Sektori i Mjedisit në vazhdimësi ka monitoruar ndotjen nga "Sharrcem" dhe operatorët tjerë ekonomik dhe lidhur me këtë do ti përgaditë një informatë të veçantë Kuvendit të Komunës.

Përshkak të Covid 19 dhe si pasojë e ndalimit të tubimeve Komuna nuk ka shënuar ditën ndërkombëtare të Tokës, të Mjedisit si dhe aktivitete të tjera të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit. Sektori i Mjedisit së bashku me MMPH ka bërë dhe vlerësimin e deponive ilegale nga 26 të identifikuar 24 janë eliminuar. Po ashtu, në periudhën raportuese sektori i mjedisit ka lëshuar 4 pëlqime mjedisore dhe një pëlqim sanitar të cilat ndërlidhen me leje të ndërtimit.

Të hyrat e sektorit të Mjedisit për vitin 2020 dhe krahasimi me vitin 2019

Emërtimi	VITI 2019	VITI 2020	Rritja në %
Të hyrat nga gjobat mandatore	250 €	240 €	
Të hyrat nga pëlqimet e dhëna mjedisore	1,523 €	2,682 €	
Gjithësejt të hyrat	1,773 €	2,922 €	64.8%

VII KADASTRI

Si pasojë e veprimit të pandemisë covid 19, vitin 2020 është shënuar ulje e kërkesave të qytetarëve për shërbime të ndryshme kadastrale. Ky numër i kërkesave është më i vogël për 161 lëndë apo 9.1% më pak se periudha e njëjtë e vitit të kaluar. vitin 2020, kadastrat ka përfunduar gjithësejtë 1755 lëndë dhe ka realizuar të hyra në shumë prej 17,300€.

Të hyrat e sektorit të kadastrit për vitin 2020 dhe krahasimi me vitin 2019

Emërtimi	VITI 2019	VITI 2020	Ulje në %
Numri i lëndëve të kryera	1916	1755	9.1%
Të hyrat e realizuara	20,984 €	17,300 €	21.2%

VIII TË HYRAT E DREJTORISË PËR PËR VITIN 2020

Vitin 2020, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjrdisit ka realizuar të hyra në shumë prej 30,318 € ap 2.2% më shumë se vitin 2019.

Të hyrat e DUKMM për periudhën Janar-Dhjetor 2020

Emërtimi	VITI 2019
Taksa komunale per leje ndertimi	12,209.76
Taksa per regjistrimin e trashigimisë	2,870.00
Shërbime kadastrale tjera	8,233.00
Taksa per legalizim	567.00
Gjobat nga inspektorati	240.00
Shfrytëzimi i pronës publike	6,197.00
Gjithësejtë D U K M M	30,318 €

HANI I ELEZIT
21.01.2021



DREJTORI I DUKMM
Nexhmedin Daci

Nexhmedin Daci